

**V E N D I M**  
**Nr. 343, datë 21.7.1999**

**PËR KRIJIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMEVE  
TË TRANSPORTIT RRUGOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 25 të “Kodit Civil”, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, në varësi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, me qendër në Tiranë dhe me emër të shkurtuar **DPSHTRR**.

2. Objekti i veprimtarisë së kësaj drejtorie të jetë shërbimi ndaj subjekteve, shtetërore dhe private, në veprimtarinë e transportit rrugor, për rregjistrimin e mjeteve, për ndërrimin e pronësisë së tyre, pajisjen me targa, për kontrollin teknik të mjeteve, për pajisjen e mjeteve me leje-drejtimi, për ngritjen dhe informatizimin e regjistrit kombëtar të mjeteve e të drejtuesve të mjeteve dhe për transmetimin e menjëhershëm të të dhënave të kërkuara nga policia e rendit, si dhe dhënien e licencave.

3. Kjo Drejtori do të jetë institucion shtetëror, me statusin e personit juridik, publik, i cili do të vetëfinancohet.

4. Kompetencat, detyrat dhe të drejtat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe të drejtorive rajonale përcaktohen në statutin e kësaj Drejtorie, e cila miratohet nga Ministri.

5. Emërimi i drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor bëhet nga Kryeministri me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit.

6. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Rendit Publik të marrin masat për kalimin në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor të veprimtarisë së rregjistrimit të mjeteve, të pajisjes së drejtuesve të mjeteve me leje-drejtimi, si dhe të kartotekës e të personelit përkatës, sipas afateve dhe mënyrës së përcaktuar në marrëveshjen ndërmjet tyre.

7. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Rendit Publik me zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Pandeli Majko**